



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 06 qershor 2018, në mbledhjen konstituive të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, kryesues

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevojë të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Labinot Sadiku-MPB; Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri – OSBE.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, zonja dhe zotërinjë, anëtarë të KKSB-së dhe mysafirë të nderuar, më lejoni të hap mbledhjen konstituive të KKSB-së. Në kuadër të mandatit të ri, konform konform Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për themelimin e përbërjes së re të KKSB-së i kam ndërmarrë të gjitha veprimet për përmbushjen e obligimeve sipas këtij akti nënligjor, në formë të shkruar janë ftuar të gjitha subjektet relevante që të propozojnë anëtarët e tyre në KKSB.

Propozimi i vendimit për themelimin e KKSB-së, sipas propozimeve të pranuar i është dërguar Kuvendit për miratim, vendim i cili edhe është miratuar.

Në përbërje të këtij Këshilli shtatë anëtarë janë të caktuar sipas pozitës në strukturat dhe institucionet e Komunës, ndërsa anëtarët tjerë janë të caktuar në cilësinë e përfaqësuesve të subjekteve relevante duke përfshirë edhe përfaqësues të komuniteteve dhe bashkësive fetare.

Sipas Udhëzimit përkatës, siç jeni të informuar, parashihet mbajtja e gjashtë mbledhjeve obligative brenda një viti dhe në funksion të angazhimit dhe dhënies së kontributit është paraparë kompensimi për pjesëmarrje të anëtarëve në mbledhje në lartësinë e mëdijëve ekuivalente me anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financave.

Unë besoj se do të angazhohemi maksimalisht në përmbushjen e përgjegjësisë konform këtij akti nënligjor dhe unë ju siguroj se do të jem i hapur për bashkëpunim dhe

bashkërendim të aktiviteteve në funksion të punës sa më të suksesshme të këtij Këshilli i cili ka një rëndësi të veçantë për të gjithë ne që jemi këtu por edhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Unë ju dëshiroj punë të mbarë.
Në këtë mbledhje edhe pse e natyrës konstituive, krahas kemi paraparë edhe disa pika tjera, kështu që mund të fillojmë me punë.

1. Konstituimi i përbërjes së re të KKSB-së

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, siç e theksova, është takimi i parë, konstituiv i këtij Këshilli, unë do të lexoj edhe emrat e anëtarëve sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e përbërjes së re të KKSB-së.

Kryetari në vazhdim lexoi emrat e anëtarëve të cilët njëherit konfirmuan pjesëmarrjen. Shtoi, Këshilli ka mbetur të plotësohet edhe me një anëtar që është Kryesuesi i këshillit komunal të prindërve, këshill i cili ende nuk është konstituuar dhe nuk është zgjedhur kryesuesi i atij këshilli, e që presim së shpejti që KKSB të plotësohet edhe me një anëtar të ri.

Në ndërkohë ka arritur një kërkesë nga Këshilli i Bashkësisë Islame që të bëhet zëvendësimi i përfaqësuesit të tyre, ne kërkesën do ta procedojmë në Kuvend për zëvendësimin e përfaqësuesit. Me këtë paraqitje dhe njoftim të Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e KKSB konstatoj konstituimin e Këshillit dhe nga sot punojmë bashkërisht për trajtojtimin e çështje që janë në fushëveprim të këshillit por edhe të marrim vendime dhe qëndrime të nevojshme për sitata të ndryshme që mund të na krijohen apo situata që mund t'i parashohim për të mirën e qytetarëve të Komunës.

KKSB është themeluar me vendimin e Kuvendit dhe me këtë konfirmim të pjesëmarrjes konstatoj konstituimin e KKSB-së.

Në propozim të Kryetarit dhe pas aprovimit njëzëri nga anëtarët e Këshillit, koordinator për koordinimin e punëve dhe aktiviteteve u zgjodh z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

2.Ngritja e grupeve punuese për:

-Përgatitjen e propozimit të Planit të punës për vitin 2018

-Përgatitjen e Informatës për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2017

-Përgatitjen e propozimit të Planit të punës për vitin 2017

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, në kuadër të kësaj pike do të ngritim një grup punues për hartimin e propozim planit të punës për KKSB për vitin 2018. Grupi për mbledhjen e radhës të përgatit një draft të dokumentit të cilin do ta shqyrtojmë.

Konstatim:

Kryetari pas aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2018, në përbërje:

1.Faik Muçiqi

2.Bekim Bislimi

3. Agim Blakçori
4. Naim Bajraktari
5. Shaban Ahmeti
6. Donjetë Sheqiri

-Përgatitja e Informatës për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2017

Konstatim:

Kryetari pas aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për përgatitjen e Informatës për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2017, në përbërje:

1. Faik Muçiqi
2. Bekim Bislimi
4. Liman Zeqiri
5. Rizah Muqolli

z. Faik Muçiqi, theksoi jemi në vonesë këtë vit dhe meqenëse sipas Udhëzimit Administrativ përkatës duhet mbajtur 6 mbledhje, atëherë duhet përshpejtuar në përgatitjen e Planit të punës, në mënyrë që ta procedojmë për miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit. Pra duhet ta mbajmë së shpejti edhe një mbledhje të KKSB-së për shqyrtim dhe miratim të Planit të punës.

z. Agim Velu, Kryetar i Komunës, theksoi, atëherë të dakordohemi për mbajtjen edhe të një mbledhjeje të Këshillit dhe kjo të jetë për datën 14.06.2018, në ora 10:00.

3. Të ndryshme

Nuk pat diskutime.

Kryetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 10.50

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. 02-035/02-0046654/18
Podujevë,
06 qershor 2018

Kryetari i Komunës
Agim Velu